



NGROHTORJA - BASHKIMIA E SHPËRBUJESËVE TË TRANSPORTIT DHE TË TREGUT

DR. GJ. BEHËJE DASHI - KRYETAR

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Më : 09.03.2023

Nr: 154

RREGULLORE PËR PAGAT, KOMPENSIMET DHE SHITESAT TJERA

Gjakovë

Mars, 2023

Në mbështetje të dispozitave të Nenit 65 (1) dhe Nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 13 qershor 2008 ka aprovuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike, nr 03/L-087 ku në bazë të Nenit 20 e 22 dhe Ligjit të Punës, nr 03/L-212 në bazë të Nenit 55 e 56, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike " Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë në mbledhjen e mbajtur më 09.03.2023, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR PAGAT, KOMPENSIMET DHE SHITESAT TJERA

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton mbarëvajtjen e procedurave dhe kushteve të barabarta për pagat, kompensimeve dhe shtesave tjera për të punësuarit në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A.

Me këtë akt rregullohen pagat mujore, kompensimet dhe shtesat tjera, të cilat ju paguhen të punësuarve të N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. në përputhje me obligimet dhe përgjegjësitë e tyre për kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.

Neni 2

Kjo Rregullore zbatohet në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. dhe vlen për të gjithë të punësuarit në këtë ndërmarrje.

Neni 3

Pagat, kompensimet dhe shtesat në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. do të realizohen në përputhje me këto parime:

- a) Parimi i ligjshmërisë,
- b) Parimi i proporcionalitetit,
- c) Parimi i mos-diskriminimit,
- d) Parimi i barazisë,
- e) Parimi i transparencës

Neni 4

N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A Gjakovë duhet të analizojë planin e buxhetit për vitin vijues për pagat, kompensimet dhe shtesat tjera duke marrë në konsideratë të drejtat e të punësuarve në realizimin e të ardhurave personale si dhe qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të ndërmarrjes.

Neni 5

Të drejtën për pagë të rregullt mujore, kompensimet dhe shtesat për punë jashtë orarit, kompensimet për punë të natës, kompensimet për punë gjatë festave zyrtare dhe shtesat tjera të parapara me këtë rregullore, i punësuari i realizon sipas ligjeve në fuqi, akteve të brendshme të N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A Gjakovë dhe kontratës së punës të nënshkruar mes të dy palëve.

Neni 6

I punësuari, për punën të cilën e realizon, merr pagën mujore sipas kontratës së punës, lartësia e së cilës nuk mund të caktohet nën pagën minimale të paraparë me aktet ligjore përkatëse në fuqi.

Neni 7

1. Pagat, kompensimet dhe shtesat në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. përcaktohen sipas kriterëve në vijim:
 - a) Pozita në Organogram – Përgatitja arsimore,
 - b) Rëndësia e pozitës sipas përgjegjësisë,
2. Bazuar në Rregulloren mbi Organizimin e brendshëm, Sistemin, Përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës. Kriteret e kategorizimit vlerësohen nga Komisioni i Auditimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Tabela e Kategorizimit të pagave dhe shtesat tjera për vendet e punës i bashkëngjitet kësaj Rregullore.

II. PAGAT

Neni 8

1. Pagat paguhen çdo muaj dhe për çdo kompensim apo pagesë shtesë tjetër organi kompetent (Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, Kryshefi Ekzekutiv) duhet të nxjerrë/merr vendim.
2. Pagat për të punësuarit e N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë paguhen përmes transferit bankar ndërsa ruhen regjistrat mbi pagat që pasqyrojnë qartë pagën bazë, bruto dhe pagesat tjera.
3. Në çdo rast i punësuari sipas kërkesës së tij mund të merr edhe dëshminë me infot mbi pagën, një dokument me shkrim se si është kalkuluar paga dhe çdo lloj kompensimi apo shtese tjetër.

Neni 9

I punësuari për punën e vet do të merr pagën një herë në muaj sipas kategorizimit të vendeve të punës, në përputhje me tabelën e kategorizimit të pagave për vendet e punës në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë dhe raportet e punës të plotësuara nga eprorët e departamenteve/zyrës të cilat duhen të dorëzohen të zytari përgjegjës për përpilimin e listave të pagave për çdo muaj.

III. KOMPENSIMET

Neni 10

1. Për punën në ditët e festave zyrtare, punën e natës apo për punën më të gjatë se orari i rregullt, të punësuarit i kompensohen me ditë të lira për ti shfrytëzuar me kërkesë të tij e aprovim paraprak.
2. Të punësuarit i takojnë shtesë në përqindje, sikurse në vijim;
 - c) 20% në orë për kujdestari;
 - d) 30% në orë për punë gjatë natës;
 - e) 30% në orë për punë jashtë orarit;
 - f) 50% në orë për punë gjatë ditëve të festave, dhe
 - g) 50% në orë për punë gjatë fundjavës.
3. N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. mund të vendosë që për pjesën e punës shtesë, në përputhje me përqindjet e parapara sikurse mësipërm, të kompensoj punonjësit me ditë pushimi.
4. Raporti / evidenca përkatëse mbi orët lidhur me punën shtesë i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 11

Të punësuarit kanë të drejtë në kompensim të pagës pa u angazhuar në punë, në rastet si në vijim:

- a) gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet;
- b) gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;
- c) gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar dhe
- d) gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 12

E drejta për të shfrytëzuar pushimin vjetor nuk mund ti mohohet asnjërit nga të punësuarit dhe nëse eventualisht me fajin e punëdhënësit nuk është shfrytëzuar pushimi vjetor apo një pjesë e pushimit vjetor nga ndonjëri prej të punësuarve, atëherë duhet ti kompensohet proporcionalisht me të holla.

Neni 13

1. Për 6 (gjashtë) muajt e parë të lehonisë pushimi paguhet nga punëdhënësi prej 70% të pagës bazë.
2. Për 3 (tre) muajt në vijim të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kompensim prej 50% të pagës mesatare në Kosovë, sipas Ligjit të Punës në fuqi.
3. Pas kalimit të këtyre periudhave, e punësuarja ka të drejtë që sipas Ligjit të Punës, ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për 3 (tre muaj) të tjerë pa pagesë.
4. Të drejtat nga dy paragrafët e mësipërm të këtij neni mund ti barten tek babai me marrëveshje me nënën apo me automatizëm mund të marrë të drejtat e saj, nëse ajo vdes apo e braktisë fëmijën.

Neni 14

1. Të punësuarit kanë të drejtën e kompensimit të pagës së plotë për mungesën nga puna nëse për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, ka vendim të një organi të autorizuar.

2. Të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës, gjatë mungesës së përkohshme për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, por jo më gjatë se 45 (dyzetepesë) ditë në vit.

Neni 15

1. Të punësuarit gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, për qëllime zyrtare dhe në interes të N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë paguhen nga ana e punëdhënësit për çfarë para udhëtimit duhet plotësuar autorizimin për udhëtim zyrtar përkatës të cilin e aprovon Kryeshefi Ekzekutiv.
2. Kryshefi Ekzekutiv, para udhëtimit zyrtar jashtë vendit, e njofton Bordin e Drejtorëve për arsyen dhe nëse merr aprovimin e tyre, atëherë mëditja dhe shpenzimet paguhen në bazë të tarifave të përcaktuar me udhëzime dhe rregullore të institucioneve përkatëse qendrore apo komunale.
3. Zyrtari Kryesor Financiar dhe/apo Arkëtari janë përgjegjës për kalkulimin dhe vërtetimin e shpenzimeve ku raporti me të gjitha faturat origjinale i bashkëngjiten aprovimit/vendimit për udhëtimin zyrtar përkatës dhe dorëzohen brenda 30 (tridhjetë) dite pas realizimit të udhëtimit.

Neni 16

Të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës në lartësi prej 50% deri në 6 (gjashtë) muaj gjatë kohës së largimit të përkohshëm nga puna, sipas nenit 73, 74 dhe 75 të Ligjit të Punës.

Neni 17

Të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në rastin e largimit kolektiv nga puna, sipas nenit 76 të Ligjit të Punës në fuqi.

IV. SHITESAT TJERA

Neni 18

1. Paga bazë e të punësuarve në N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. rritet në bazë të përvojës së punës në masën prej 0.5% (zero pikë pesë përqind) të pagës bazë për çdo vit të plotë pune.
2. N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova SH.A. e llogaritet përvojë të punës edhe angazhimin në luftë për veteranët dhe për kategoritë tjera, të cilave ligji u njeh të drejtën e dyfishtë të përvojës së punës

3. Llogaritja e shtesës të përvojës së punës bëhet duke bazuar në evidencën e dosjes së të punësuarve.

Neni 19

1. N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A Gjakovë paguan për ushqim (shujtat ditore) për të punësuarit.
2. Të punësuarve për secilën ditë pune u paguhen nga 2.5 Euro në çdo fund të muajit bashkë me pagë.

Neni 20

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. në Gjakovë:


Kryesues,

Anëtarë/e,

Anëtarë/e,

Anëtarë/e,



Gjakove 09.03.2023